

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fage 1 nga 42</i>

## KODI I MATJES

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faje 2 nga 42</i>

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1</b>	<b>Parathënie</b> .....	<b>5</b>
<b>2</b>	<b>Përkufizime të Termave</b> .....	<b>6</b>
<b>3</b>	<b>Kushtet e përgjithshme</b> .....	<b>11</b>
3.1	Terminologjia .....	11
3.2	Rrethanat e paparashikuara.....	12
3.2.1	Ndërmarrja e veprimeve.....	12
3.2.2	Palët e prekura në pamundësi për të qenë në pajtueshmëri me këtë Kod.....	12
3.2.3	Menaxhimi i Kodit të Matjes .....	12
3.3	Mosmarrëveshjet.....	13
3.3.1	Procedura e mosmarrëveshjeve.....	13
<b>4</b>	<b>Hyrje</b> .....	<b>13</b>
<b>5</b>	<b>Objektivat</b> .....	<b>13</b>
<b>6</b>	<b>Fushëveprimi</b> .....	<b>14</b>
<b>7</b>	<b>Përgjegjësitë për Sistemet Matëse</b> .....	<b>15</b>
7.1	Instalimi dhe Mbrojtja e Pajisjeve të Matjes.....	15
7.2	Pezullimi i përkohshëm dhe rehabilitimi i planifikuar i sistemeve matëse .....	16
7.2.1	E përgjithshme.....	16
7.2.2	Regjistrimi i sistemeve matëse që nuk janë plotësisht në pajtueshmëri.....	17
7.2.3	Periudhat e përmirësimit .....	18
7.2.4	Vlerësimi gjatë periudhave përmirësuese .....	18
7.2.5	Përjashtimet.....	19
<b>8</b>	<b>Grupet (sistemet) matëse</b> .....	<b>19</b>
8.1	Kërkesat minimale për matje.....	19
8.2	Matjet e fuqisë dhe energjisë elektrike .....	20
8.2.2	Specifikimet teknike të pajisjeve të matjes.....	24
8.2.3	Transformatorët ekzistues të matjes.....	24
8.3	Saktësia e pajisjeve të matjes .....	25
8.3.2	Klasa e Saktësisë së Pajisjeve të Matjes .....	27
8.4	Kërkesat për të dhënat e matësve me intervale .....	27

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fage 3 nga 42</i>

8.4.1	Ruajtja e të dhënave .....	27
8.4.2	Kohëmatja .....	28
8.4.3	Monitorimi i Pajisjeve .....	29
8.4.4	Pajisjet e komunikimit .....	29
8.4.5	Marrja e të dhënave lokale .....	30
8.4.6	Marrja e të dhënave në distancë .....	30
<b>9</b>	<b>Të dhënat matëse dhe mbledhja e të dhënave në distancë .....</b>	<b>30</b>
9.1	Baza e të dhënave matëse .....	30
<b>10</b>	<b>Siguria e grupeve (sistemeve) të matjes .....</b>	<b>32</b>
10.1	Vendndodhja e aparaturave .....	32
10.2	Pllombimi i aparaturave matëse .....	32
10.2.1	E përgjithshme .....	32
10.2.2	Forma e pllombës .....	33
10.2.3	Kontrolli i pajisjeve pllombuese .....	33
10.3	Pajisjet me mikroprocesor .....	35
10.3.1	Mbrojtja me pasvord .....	35
10.3.2	Niveli 1 .....	35
10.3.3	Niveli 2 .....	36
10.3.4	Niveli 3 .....	36
10.3.5	Niveli 4 .....	36
10.4	Siguria e bazës së të dhënave të matjes .....	36
10.5	Kërkesat për restaurimin e prishjeve .....	37
<b>11</b>	<b>Testimi i grupeve (sistemeve) matëse .....</b>	<b>37</b>
11.1	E përgjithshme .....	37
11.2	Aprovimi i tipeve .....	38
11.3	Kalibrimi dhe verifikimi .....	38
11.4	Kalibrimi periodik dhe ripërtëritja .....	39
11.5	Testimet rutinore në kyçjet me kapacitet të madh të Transferimit .....	39
11.6	Transformorët matës .....	40
11.6.1	Të përgjithshme .....	40
11.6.2	Të gjithë transformorët matës do të jenë objekt i kalibrimeve dhe testeve të mëposhtme .....	40
11.6.3	Kalibrimi fillestar .....	40

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faje 4 nga 42</i>

11.6.4	Testimi periodik.....	41
11.7	Grumbulluesit e të dhënave .....	41
11.7.1	Të përgjithshme .....	41
11.7.2	Kalibrimi fillestar .....	41
11.7.3	Testimi periodik.....	41
<b>12</b>	<b>Pagesa për grupet (sistemet) matëse .....</b>	<b>41</b>

## 1 Parathënie

- 1.1.1.1 **Kodi i Matjes** përcakton kërkesat minimale teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes komerciale në mënyrë që të lehtësohet veprimi i tregtimit të energjisë elektrike. Është njëri nga kodet teknike që është modeluar për të siguruar një qasje të nivelit të njëjtë jo-diskriminues dhe transparent për të gjitha palët të cilat operojnë në tregjet konkurruese të fuqisë dhe energjisë elektrike, si dhe shërbimeve përcjellëse.
- 1.1.1.2 **Kodi i Matjes** përcakton rregulla të qarta për instalimin dhe përdorimin e njehsorëve për t'u siguruar që të dhënat e prodhimit, bartjes dhe konsumit të jenë në dispozicion për të përkrahur dhe mundësuar **barazimin përfundimtar** efikas të transaksioneve të energjisë elektrike.
- 1.1.1.3 Në përputhje me **Ligjin për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit të Transmisionit** është përgjegjës për administrimin e të gjitha kodeve teknike, të cilat janë objekt i aprovimit të **Zyrës së Rregullatorit për Energji** para vënies së tyre në zbatim duke përfshirë edhe **Kodin e Matjes**.
- 1.1.1.4 Përpilimi i **Kodi të Matjes** është bërë para vendosjes së Rregullave të Tregut të cilat qartësisht përcaktojnë mënyrën në të cilën duhet të veprojnë tregu në Kosovë. Për ta mundësuar këtë është dashur të shtohen këto supozime:
- Çdo **konsumator i kualifikuar** i cili dëshiron të blejë energji elektrike nga një **furnizues** duhet të pajiset me **matësin** adekuat për të matur konsumin e energjisë elektrike dhe ka obligim të përmbush kërkesat e **barazimit përfundimtar**.
  - Çdo prodhues që dëshiron të paguhet për energjinë elektrike të transferuar në **Sistemin e Transmisionit** apo të **Shpërndarjes**, fillimisht duhet të pajiset me njehsorin adekuat për të matur transferimin e energjisë elektrike për të përmbushur kërkesat e **barazimit përfundimtar**.
  - Rregullat e tregut** mbizotërojnë aty ku ka ndonjë ndryshim mes kërkesave të **barazimit përfundimtar** brenda Kosovës dhe në tregun rajonal. Çdo palë që tregton në tregun rajonal nëpërmjet **Sistemit të Transmisionit** ose **Shpërndarjes** në Kosovë, duhet të pajiset me njehsorin adekuat për plotësimin e kërkesave më të vështira të tregut Kosovar dhe atij rajonal në secilin rast.
  - Operatorit të Sistemit të Transmisionit** dhe **Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes** nuk do i kërkohej që të llogarisin transferimet e energjisë për të cilat ata duhet të marrin pagesa për **qasje në rrjet**. Të gjitha llogaritjet e këtij lloji do të kryhen brenda procesit të **barazimit përfundimtar**.
- 1.1.1.5 **Kodi i Matjes** trajton kërkesat e matjes të energjisë elektrike të një tregu plotësisht konkurrues dhe kërkesat e transmisionit për matje.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 6 nga 42</i>

## 2 Përkufizime të Termave

2.1.1.1 Në Kodin e Matjes, aplikohen përkufizimet e mëposhtme:

Termi	Shkurtesa	Përkufizimi
<b>Barazimi përfundimtar</b>		Është emërtimi i përbashkët për proceset e përdorura për të përcaktimin e sistemit nga çdo <b>palë</b> dhe detyrimet financiare të palëve si dhe pagesat pasuese nga këto detyrime;
<b>De-energizim</b>		Shkyçja nga tensioni i një instalimi elektrik duke hapur një çelës (ndërprerës) të fundit ose duke hequr një siguresë të ndërprerësit. I de-energizuar, de-energizim do të interpretohen sipas rastit.
<b>Dita e barazimit përfundimtar</b>	e	Është <b>dita e biznesit</b> në të cilën <b>Operatori i Tregut</b> do të ndërmarrë llogaritjet e <b>barazimit përfundimtar</b> në lidhje me çdo periudhë të specifikuar të <b>periudhës së barazimit përfundimtar</b> .
<b>Ditë pune</b>	DP	Çdo ditë përveç të shtunave dhe të dielave dhe pushimeve të zbatuara normalisht në Kosovë.
<b>Energji Reaktive</b>	VARh KVARh	Energjia elektrike reaktive është integrali i caktuar me kufijë kohor i fuqisë reaktive matur në njësi volt-amper reaktive-orë ose shumëfishat e saj
<b>Energjia elektrike Aktive</b>	Wh kWh MWh	Energjia elektrike aktive është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe duke qenë integrali i caktuar i fuqisë aktive me kufij kohor.
<b>Energjizim</b>		Kyçja në tension i një instalimi elektrik duke mbyllur çelësin (ndërprerësin) e fundit ose duke vendosur një siguresë ndërprerëse. I energjizuar, energjizim do të interpretohen sipas rastit.
<b>Forca madhore</b>		Është çdo ngjarje ose rrethanë jashtë kontrollit të arsyeshëm duke përfshirë, por pa u kufizuar në një ose më shumë nga veprimet në vijim: lufta, mocionet, kryengritjet ose trazirat civile; grevat, sëmundjet epidemike, stuhia, tërmeti, rrëshqitja e tokës, bllokadat ose embargot; dëmtimet në stabilimentet ose në stabilimentet deponuese të shkaktuara nga eksplozimet, zjarri, kontaminimi jonizues, kontaminimi radioaktiv, vërshimet dhe katastrofat natyrore, nëse efektet e tilla negative nuk kanë mundur të parandalohen, anashkalohen, sanohen plotësisht apo pjesërisht nga <b>Pala</b> e prekur.
<b>Furnizues</b>		Ndërmarrjen e energjisë elektrike etë licencuar për të kryer veprimtari të furnizimit
<b>Genset</b>		Ngjajshëm me <b>njësia gjeneruese (prodhuese)</b>

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 7 nga 42</i>

Termi	Shkurtesa	Përkufizimi
<b>Grumbulluesi i të dhënave</b>		Një pajisje që mbledh të dhënat e energjisë, i grumbullon në intervale, mban në minimum prej 45 ditë të dhëna dhe është i përshtatshëm të lejojë qasjen elektronike nga <b>OST</b> nëpërmjet një lidhje telekomunikimi. Kjo pajisje mund të jetë një njësi e ndarë ose e kombinuar me pajisjet e matjes së energjisë brenda një pajisje tjetër fizike.
<b>Grupi (Sistemi) Matës</b>		Një grumbull i pajisjeve të regjistruara që trajtohen si një instalim i vetëm dhe japin një lexim të vetëm ose një grup të lidhur leximesh për <b>barazimin përfundimtar</b>
<b>Kodi i Matjes</b>		Është ky kod, i cili është përgatitur nga <b>OSTT (Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregu)</b> dhe është miratuar nga <b>Zyra e Rregullatorit për Energji</b> .
<b>Koha Universale e Koordinuar</b>	UTC	Në këtë dokument ka të njëjtin kuptim si në dokumentin Frekuenca Standarde dhe Emetimi me Sinjal Kohor, Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (CRTF.4609ISBN92-61-05311-4)
<b>Komisioni Qeverisës i Kodeve Teknike/Operacionale</b>	KQKO	Komisioni i themeluar në përputhje me dispozitat e <b>procedurës së menaxhimit të kodeve teknike/operacionale</b> që mbikëqyr funksionimin e kodeve teknike dhe operacionale
<b>Konsumator i Kualifikuar</b>		Konsumatori që është i lirë të blejë energji elektrike nga furnizuesi të cilin ai/ajo e zgjedh.
<b>Kyçja (Lidhja)</b>		Interkonekcionin i dy <b>sistemeve</b> .
<b>Licenca</b>		Dokumenti i lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që i mundëson bartësit të licencës të ushtrorë aktivitete në sektorin e energjisë për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë.
<b>Ligji për Energjinë</b>		Është ligji Nr. 03/L-184 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës
<b>Ligji për Energjinë Elektrike</b>		Është ligji Nr. 03/L-201 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
<b>Ligji për Rregullatorin e Energjisë</b>		Është ligji Nr. 03/L-185 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
<b>Marrëveshja e Kyçjes</b>		Një marrëveshje dypalëshe ndërmjet <b>OSTT</b> dhe një <b>përdoruesi</b> që detajon kushtet për kyçje me <b>sistemin e transmisionit</b> .
<b>Ministria</b>		Ministria e Republikës së Kosovës përgjegjëse për sektorin e energjisë

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajë 8 nga 42</i>

Termi	Shkurtesa	Përkufizimi
Njehsori (Matësi)		Një pajisje që mat dhe regjistron prodhimin ose konsumimin e energjisë elektrike.
Njehsori (Matësi) me intervale		<b>Pajisje e matjes</b> që integron energjinë në periudha të përcaktuara dhe i ruan ato në ato periudha.
Njehsori (Matësi) pa intervale		<b>Pajisje matëse</b> që thjesht integron energjinë dhe e ruan të regjistruar atë.
Njësia Gjeneruese		Grup pajisjesh që prodhojnë energji elektrike.
Operator i Sistemit të Transmisionit	OST	Person fizik ose juridik përgjegjës për operimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmisionit dhe zhvillimin e rrjetit të transmisionit, aty ku aplikohet, interkonektorëve të vet me rrjete të tjera, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të rrjetit për të përballur me kërkesat për transmisionin e energjisë elektrike.
Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregu	OSTT	Është Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike, i cili është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë, sigurimin e qasjes së hapur dhe jodiskriminuese dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike.
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	OSSh	Ndërmarrje energjetike përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, për sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike.
Operatori i Sistemit	OS	OS ka në pronë ose operon me <b>sistemin e transmisionit</b> ose sistemin e <b>shpërndarjes</b> në të cilin janë të kyçur <b>përdoruesit e sistemit</b> .
Operatori i Tregut	OT	Ndërmarrje energjetike e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të operuar me tregun e energjisë elektrike në Kosovë;
Pajisjet e matjes		Instrumentet e regjistruara në regjistrin për pajisjet matëse të certifikuar në Republikën e Kosovës, që përdoren për matje të energjisë së prodhuar, transmetuar, shpërndarë, furnizuar dhe të konsumuar
Palë		Çdokush që operon në tregun e organizuar të energjisë elektrike të Kosovës ose kryen shërbime për të bërë të mundur funksionimin e tregut.



Termi	Shkurtesa	Përkufizimi
Periudha e barazimit përfundimtar		Është intervali i vendosur në <b>rregullat e tregut</b> (ose në rastin e tregimit të energjisë jashtë kufijve të Kosovës nga ENTSO_E) në të cilin dërgesa e energjisë dhe dërgesa sipas kontratës maten në periudhën e parë të shlyerjes të <b>barazimit përfundimtar</b> për çdo ditë që fillon në mesnatë.
Pika e furnizimit		Pika e furnizimit është vendndodhja fizike ku realizohet lidhja e përdoruesit/konsumatorit me sistemin e transmisionit apo shpërndarjes në të cilën plotësohen kërkesat e përgjithshme të saktësisë siç thuhet në <b>rregullat e tregut</b> ose në këtë kod. Këto vendndodhje janë plotësisht të përcaktuara në <b>Marrëveshjet e Kyçjes</b> relevante.
Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale		Procedura e qeverisjes së kodeve teknike/operacionale të nxjerra nga <b>Zyra e Rregullatorit për Energji</b> në pajtim me nenin 14.2(16) të <b>Ligjit për Rregullatorin e Energjisë</b> .
Prodhimi (Gjenerimi)		Prodhimi i energjisë elektrike.
Pika e kyçjes		Pika e dakorduar për furnizimin e vendosur ndërmjet <b>OSTT</b> dhe një <b>përdoruesi</b> .
Qasja në Rrjetë		Një marrëveshje sipas së cilës <b>Operatorët e Sistemit</b> bien dakord t'i lejojnë përdorimin e rrjetit të tyre transmetues ose <b>rrjetit shpërndarës</b> çdo <b>pjesëmarrësi në treg</b> .
Qendra për leximin e të dhënave në distancë		Qendra kryesore e të dhënave e ngritur nga <b>OSTT</b> me qëllim leximin nga larg të <b>sistemeve matëse</b> të cilat bazohen në mikroprocesor dhe mund të pranohen nëpërmjet një apo më shumë lidhje komunikimi.
Rregulla për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji		Një rregull mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji i nxjerrë nga Zyra e <b>Rregullatorit për Energji</b> .
Rregullat e Tregut		Janë rregullat të cilat janë përgatitur nga <b>Operatori i Tregut</b> dhe miratuar nga <b>Zyra e Rregullatorit për Energji</b> .

Termi	Shkurtesa	Përkufizimi
<b>Rregulla për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë</b>		Rregulla të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, që paraqesin bazën për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë.
<b>Sistemi i Shpërndarjes</b>	SSh	Kombinimi i linjave të energjisë elektrike dhe pajisjeve të energjisë elektrike me tension të lartë të mesëm dhe të ulët që shërbejnë për shpërndarjen e energjisë elektrike.
<b>Sistemi i Transmisionit</b>	ST	Kombinimi i linjave të energjisë elektrike dhe njërive të energjisë elektrike me tension të lartë që shërben për transmisionin e energjisë elektrike.
<b>Shfrytëzuesi (Përdoruesi) i Sistemit</b>		Një <b>përdorues i sistemit</b> është një person fizik ose juridik i cili përdor <b>Sistemin Transmetues të OST</b> ose <b>Sistemin Shpërndarës</b> të një <b>OSSH-je</b> ashtu siç duhet, duke përfshirë: Konsumatorët e mëdhenj pajisjet e të cilëve lidhen me <b>Sistemin Transmetues</b> ose <b>Sistemin Shpërndarës</b> ; <b>Prodhuesit</b> , pajisjet e të cilëve lidhen me <b>Sistemin Transmetues</b> ose <b>Sistemin Shpërndarës</b> ; Sistemet tjera të transmisionit , rrjetet e të cilëve ndërlidhen me atë të <b>OST</b> (Operatori i Sistemit të Transmisionit) <b>Sistemet e Shpërndarjes</b> , rrjetet e të cilëve ndërlidhen me atë të <b>OST</b> ose të një <b>OSSH-je</b> tjetër, dhe <b>Konsumatorët</b> e energjisë elektrike.
<b>Tarifat për Qasje në Rrjet</b>		Tarifa e vendosur nga <b>Operatori i Sistemit</b> dhe e miratuar nga <b>Zyra e Rregullatorit për Energji</b> e cila përdoret për t'i ngarkuar <b>përdoruesit e sistemit</b> për shfrytëzimin e rrjetit.
<b>Të dhënat matëse</b>		Janë leximet nga njehsorët që i jepen <b>Operatorit të Tregut</b> nga një <b>sistem matës</b> nga <b>pala</b> relevante që do të jetë gjithashtu <b>OST</b> ose <b>Operatori i Sistemit të Shpërndarjes</b> .
<b>Transformator Matës</b>		Emri i përgjithshëm për pajisjet matëse ku përfshihen <b>transformatorët matës të rrymës (TMRR)</b> dhe <b>transformatorët matës të tensionit (TMT)</b>
<b>Transformator i matës i rrymës</b>	TMRR	Një transformator për përdorim me <b>njehsorët</b> dhe/ose pajisjet mbrojtëse në të cilat rryma e bobinave (pëstjellave) sekondare është brenda kufijve të përkufiuara të gabimit në përpjestim dhe në fazë me rrymat në bobinat (pëstjellat) në anën primare.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 11 nga 42</i>

Termi	Shkurtesa	Përkufizimi
<b>Transformatori Matës i Tensionit</b>	TMT	Një transformator që përdoret nga <b>njehsorët</b> dhe/ose pajisjet mbrojtëse në të cilat tensioni përmes terminaleve të qarqeve sekondare është brenda kufijve të përkufizuar të gabimit, në përpjestim me dhe në fazë me tensionin e aplikuar në terminalet e qarqeve primare.
<b>Transmision</b>		Transportimi i energjisë elektrike, përmes sistemeve të interkonektuara me tension të lartë, me qëllim të dërgimit deri te konsumatorët fundorë apo te operatorët e sistemit të shpërndarjes, por pa përfshirë furnizimin;
<b>Zyra e Rregullatorit për Energji</b>	ZRrE	Rregullatori i pavarur i aktiviteteve energjetike, me kompetencat e përcaktuara në Ligjin e Rregullatorit për Energji, në Ligjin për Energjinë dhe në ligjet tjera që rregullojnë ushtrimin e aktiviteteve të energjisë.

### 3 Kushtet e përgjithshme

#### 3.1 Terminologjia

3.1.1.1 Përveç kuptimeve të veçanta në Përkufizimet e Termave të mësipërme, brenda këtij dokumenti disa fjalë dhe shprehje kanë kuptimet e mëposhtme:

- Referimet në gjininë mashkullore do të përfshijnë edhe gjininë femërore dhe referimet në njëjës do të përfshijnë edhe referimet në shumës dhe e kundërta.
- Aty ku ky **Kodi i Matjes** specifikon dhënien e informacionit me shkrim ose konfirmimit me shkrim, atëherë çdo mjet tjetër i përshtatshëm i transferimit elektronik që i mundëson marrësit ta ruaj informacionin – i tillë si posta elektronike ose Faksi do ta përmbushnin këtë detyrim.
- Përveç rasteve ku qartësisht thuhet ndryshe të gjitha referimet në seksione do të jenë referime për seksionet e këtij **Kodi të Matjes**.
- Koha ose referimet e tjera ndaj kohës do t'i referohen orës standarde në Kosovë e cila është një orë para **Kohës Universale të Koordinuar (UTC)**.
- Çdo referim në një ligj apo rregullore do të jetë referim në atë ligj apo rregullore të aplikueshme në Kosovë, ose në rast se ato zëvendësohen, të ligjit apo rregullores së re që nga data në të cilën ato hyjnë në fuqi.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 12 nga 42</i>

## 3.2 Rrethanat e paparashikuara

### 3.2.1 Ndërmarrja e veprimeve

3.2.1.1 Nëse krijohen rrethana të tilla që dispozitat e këtij Kodi të Matjes nuk mund të jenë parashikuar në mënyrë të arsyeshme, **OST** do të konsultohet menjëherë, aq sa të jetë praktikisht e arsyeshme në ato rrethana, me të gjitha palët e dëmtuara dhe **Komisionin Qeverisës të Kodeve Teknike/Operacionale (KQKO)** në përpjekje për të arritur marrëveshje në lidhje me masat që duhet të ndërmerren (nëse ka të tilla). Nëse marrëveshja mes **OST** dhe atyre palëve nuk mund të arrihet në kohën në dispozicion, **OST** duke vepruar me arsyeshmëri do të përcaktojë se cilat masa duhet të merren. **OST** do t'i njoftojë palët dhe **Zyrën e Rregullatorit për Energji** rreth vendimeve dhe arsyeshmërive të tij sa më parë që të jetë e mundur.

3.2.1.2 Kurdo që **OST** merr një vendim, këtë do ta bëjë duke marrë parasysh, mendimet e shprehura nga palët e tjera në çdo rast të arsyeshëm.

3.2.1.3 Pas ndonjë ngjarje, **OST** do t'ia referojë menjëherë të gjitha rrethanat e tilla të paparashikuara dhe të gjitha vendimet e tilla **komisionit qeverisës të kodeve teknike/operacionale** për konsiderim në përputhje me nenin 3.2.3.

### 3.2.2 Palët e prekura në pamundësi për të qenë në pajtueshmëri me këtë Kod

3.2.2.1 Kur një palë e ka të pamundur të jetë në pajtueshmëri me detyrimet e tij sipas këtij kodi për arsye të një **force madhore**, pala mund t'i dërgoj një njoftim të gjitha palëve të dëmtuara dhe **Zyrës së Rregullatorit për Energji** duke detajuar arsyet për pamundësinë e tij që t'i përmbushë detyrimet, pse beson se këto arsye janë rast i **forcës madhore** dhe për kohëzgjatjen e **forcës madhore**.

3.2.2.2 Gjatë kohëzgjatjes së **forcës madhore**, detyrimet e palëve do të pezullohen.

3.2.2.3 Nëse ndonjë palë beson se deklarimi i **forcës madhore** është i pa-arsyeshëm, mund t'ia referojë çështjen **Zyrës së Rregullatorit për Energji** për rishikim dhe vendimi i **Zyrës së Rregullatorit për Energji** do të jetë përfundimtar. Në rast se **Zyra e Rregullatorit për Energji** vendos se arsyet për mos-pajtueshmëri nuk ishin rast i **forcës madhore**, atëherë detyrimet e palës pretenduese nuk do të konsiderohen si të pezulluara.

### 3.2.3 Menaxhimi i Kodit të Matjes

3.2.3.1 Kodi i Matjes është përgatitur nga **OSTT** në përputhje me detyrimet e tij sipas Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të miratuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji**. Kodi i Matjes parashtron kushtet që duhet të plotësohen nga të gjitha palët në rrethanat që mbulon ky kod.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 13 nga 42</i>

3.2.3.2 Rishikimet e Kodit të matjes do të ndërmerren nga **komisioni qeverisës i kodeve teknike/operacionale** i themeluar në përputhje me procedurën e menaxhimit të kodeve teknike/operacionale të miratuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji. OSTT** do të marrë përgjegjësinë për inkorporimin e ndryshimeve që janë dakorduar nga **KQKO** dhe janë miratuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji** dhe do të nxjerrë versionet e amendamentuara (ndryshuara) të kodit sipas kërkesave.

### 3.3 Mosmarrëveshjet

#### 3.3.1 Procedura e mosmarrëveshjeve

3.3.1.1 Dispozitat e Kodit të Matjes janë të detyrueshme dhe janë në përgjithësi specifike kur mbulojnë shumicën e situatave që ka gjasa të paraqiten në fushat e mbuluara nga Kodi i Matjes. Të gjitha palët në zbatimin e kodit duhet të veprojnë me mirëbesim gjatë gjithë kohës. Qëllimi duhet të jetë përpjekja, sa më shumë që të jetë e mundur, që të sigurohet se nuk do të ndodhin mosmarrëveshje.

3.3.1.2 Mosmarrëveshjet që paraqiten si rezultat i operimit të Kodit të Matjes do të zgjidhen në përputhje me **Rregullin për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë** të miratuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji** si një mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që paraqiten mes palëve në tregun e energjisë.

## 4 Hyrje

4.1.1.1 Kodi i Matjes ka për qëllim të formoj bazën për matjen komerciale të energjisë në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.

4.1.1.2 Të dhënat e sakta të matjes janë thelbësore për funksionin e barazimit përfundimtar dhe për të siguruar qasjen jo-diskriminuese në **Sistemin e Transmisionit dhe Sistemin e Shpërndarjes**. Ky Kod përshkruan të drejtat dhe detyrimet e palëve për sa i përket matjes së sasive të energjisë elektrike për të siguruar që të dhënat matëse mund të merren në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit në treg të kenë të drejta të barabarta.

## 5 Objektivat

5.1.1.1 Kodi i Matjes përshkruan pajisjet matëse që kërkohen për të gjitha pikat kyçëse mes dy sistemeve, mes sistemeve dhe njërive gjeneruese dhe në pikat e furnizimit të konsumatorëve. Përcakton të drejtat dhe detyrimet që ka secila palë, veçanërisht ato të Operatorëve të Sistemit, duke përfshirë edhe ato të **Zyrës së Rregullatorit për Energji**. Mbulon çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e sistemeve dhe ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave.

5.1.1.2 Ky Kod detajon standardet minimale për matjen dhe regjistrimin e sasive të matura të energjisë elektrike që do të përdoren për caktimin e shitjeve dhe blerjeve të

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 14 nga 42</i>

energjisë elektrike në tregun e energjisë elektrike – duke përfshirë ato që nevojiten për tregtimin që e ka origjinën ose përfundon jashtë Kosovës. Cakton dispozitat në lidhje me instalimin, testimin, mirëmbajtjen dhe vënien në funksionim të sistemeve matëse duke përfshirë lidhjet përkatëse të komunikimit. Përkufizon kërkesat për saktësi, parametrat që duhet të maten dhe kërkesat për mirëmbajtje dhe testim.

## 6 Fushëveprimi

- 6.1.1.1 Kodi i Matjes përcakton pajisjet që do të sigurohen dhe procedurat që do të ndiqen për matjen dhe regjistrimin e dërgimeve të energjisë për qëllime të barazimit përfundimtar brenda rrjetit të energjisë elektrike të Kosovës.
- 6.1.1.2 Dispozitat e këtij Kodi do të aplikohen për të gjitha kyçjet në rrjet siç janë:
- a) Pikat interkonektive në mes **Sistemit të Transmisionit** dhe **Sistemit të Shpërndarjes**,
  - b) Pikat interkonektive në mes sistemeve që i përkasin **Operatorëve të Sistemeve të Shpërndarjes** të ndryshme,
  - c) **Kyçjet** ku prodhimi i energjisë elektrike hyn në **rrjetin e OST** ose në atë të një **OSSH**-je prej rrjetit të një **përdoruesi** të sistemit (kyçjet e gjenerimit).
  - d) **Kyçjet** ku furnizimi me energji realizohet nga **përdoruesi i sistemit** nga rrjeti i **OST** -ës ose të një **OSSH**-je (kyçjet e furnizimit), dhe
  - e) **Kyçjet** ku energjia i sigurohet rrjetit të një **OSSH**-je prej rrjetit të një konsumatori i cili merr energji nga **Sistemi i Transmisionit**.
- 6.1.1.3 Dispozitat e këtij Kodi do të aplikohen për të gjithë personat fizik dhe juridik, të cilët janë:
- a) Zotëruesit e një licence për të ndërmarrë ndonjërin nga aktivitetet e licencuara në lidhje me industrinë e energjisë elektrike në Kosovë,
  - b) **Konsumatorët** e energjisë elektrike edhe nëse janë të kualifikuar të zgjedhin **furnizuesin** e tyre, dhe
  - c) Pronar apo operator të ndonjë rrjeti elektrik që është i lidhur me rrjetin e një **Operatori të Sistemit** të licencuar.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 15 nga 42</i>

## 7 Përgjegjësitë për Sistemet Matëse

### 7.1 Instalimi dhe Mbrojtja e Pajisjeve të Matjes

- 7.1.1.1 Siç thuhet në **Ligjin për Energjinë Elektrike** dhenë rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, pajisjet matëse do të sigurohen nga përdoruesit e sistemit dhe instalohen nga **Operatori i Sistemit** në rrjetin e të cilit bëhet një kyçje.
- 7.1.1.2 **Operatori i Sistemit** do të përcaktoj vendin ku duhet të instalohen pajisjet e matjes duke marrë në konsideratë kërkesat e këtij Kodi të Matjes dhe të gjitha kërkesat e dala nga rregulloret relevante.
- 7.1.1.3 Pas vënies në punë të sistemit matës, përdoruesi i sistemit do t'i raportoj **Operatorit të Sistemit** në lidhje me çdo problem të dyshuar rreth pajisjes.
- 7.1.1.4 Përdoruesi i sistemit do të siguroj që vendi i zgjedhur të mbetet një vend i përshatshëm për pajisjen e matjes duke pasur parasysh në veçanti kërkesat për qasje dhe sigurinë e pajisjes së parashtruar në seksionin 10.1.1.1.
- 7.1.1.5 Aty ku përdoruesi i sistemit beson se vendi i zgjedhur nga **Operatori i Sistemit** është një pozicion i paarsyeshëm për pajisjen e matjes që do të instalohet, përdoruesi i sistemit mund t'ia referoj çështjen procedurës së mosmarrëveshjes në bazë të Rregullit për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë.
- 7.1.1.6 Obligimet për mirëmbajtje, kontrollim dhe lexim të pikës matëse:
- a) Për **matjen** në kufi mes **Sistemit të Transmisionit** dhe **Sistemit të Shpërndarjes, gjeneruesve, konsumatorëve të drejtpërdrejtë** përgjegjës për **sistemin matës** është **OST**;
  - b) Kufiri mes rrjetit të një konsumatori i cili merr energji nga **Sistemi i Transmisionit** dhe **Sistemi i Shpërndarjes** të një **OSSH-je**, do të jetë pika kyçese përkatëse me sistemin përkatës. Përgjegjës për matje në mes të konsumatorit dhe **Sistemit të Transmisionit** është **OST**, kurse në mes të konsumatorit dhe **Sistemit të Shpërndarjes** është **OSSH**;
  - c) Aty ku energjia sigurohet nga rrjeti i konsumatorit për **Sistemin e Shpërndarjes**, duhet të konsiderohet si kyçje mes **Sistemit të Transmisionit** dhe rrjetit të një **OSSH-je**, andaj **OSSH-ja** do të jetë përgjegjës për **sistemin matës**, ndërsa **OST** do të bëjë leximin periodik për nevojat e **Operatorit të Tregut** me qëllim të **barazimit përfundimtar**



	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 16 nga 42</i>

- 7.1.1.7 Për matjen në kufijtë e dy ose më tepër **OSSH**-ve, përgjegjës për sistemin e matjes do të jetë njëra **OSSH** (sipas një marrëveshje), apo në rastin specifik **OSSH** rrjeti i të cilit është elektrikisht më afër rrjetit transmetues.
- 7.1.1.8 Për matjen në kufijtë mes rrjetit të energjisë elektrike të Kosovës dhe çdo rrjeti tjetër të energjisë elektrike përgjegjës do të jetë **Operatori i Sistemit** që mban licencën e lëshuar nga Rregullatori për të siguruar që sistemi matës plotëson kërkesat e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve relevante të Kosovës, duke përfshirë këtë kod dhe marrëveshjet relevante ndërshtetërore.
- 7.1.1.9 Në nënstacionet dhe objektet të cilat janë pronë e **OST**-së, për matjet e shpenzimeve vetjake të nënstacioneve/objekteve të **OST**-së që furnizohen nga rrjeti i **OSSH**-së, përgjegjës për sistemin matës është **OSSH**-ja. Klasa e saktësisë e njehsorëve duhet të jetë 0.5 (për aktive) dhe 1.0 ose 2.0 (për reaktive). Është e mjaftueshme që për këto pika matëse të vendoset vetëm nga një njehsor dhe ate vetëm ai kryesor.

## 7.2 Pezullimi i përkohshëm dhe rehabilitimi i planifikuar i sistemeve matëse

### 7.2.1 E përgjithshme

7.2.1.1 Aty ku grupet (sistemet) matëse që për momentin janë në shërbim nuk i plotësojnë kërkesat e këtij kodi dhe/ose të rregulloreve ekzistuese, përdorimi i tyre në vazhdim do të lejohet në përputhje me aranzhimet e mëposhtme derisa sistemi matës mund të përmirësohet në një mënyrë të planifikuar. Asnjë pezullim i përkohshëm nuk do të lejohet për grupet (sistemet) matëse që vihen në punë pas datës së miratimit të këtij Kodi të Matjes përveç rasteve kur grupi (sistemi) matës nuk është në pajtueshmëri me dispozitat e një ndryshimi të këtij Kodi të Matjes që hyn në fuqi pas datës së vënies në punë të grupit (sistemit) matës. Në atë rast do të lejohet nxerrje e një pezullimi të përkohshëm në emër të atij ndryshimi, ose ndonjë ndryshimi tjetër pasues.

7.2.1.2 Parimet për përdorim të vazhduar të pajisjeve të tilla matëse janë:

- a) Që **përdoruesi i sistemit** të mos dëmtohet për shkak se **Operatori i Sistemit** është i paaftë të përmirësojë **pajisjet e matjes**.
- b) Që **përdoruesi i sistemit** të ketë mundësinë të kërkojë një ndërrim të **pajisjeve të matjes** në përputhje me dispozitat e **Ligjit për Energjinë Elektrike** dhe kushteve për kyçje të përcaktuara nga **Rregulli për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji** dhe të presë që ky ndërrim të ndodh brenda një periudhe të arsyeshme kohore.



- c) Që një **Operator i Sistemit** duhet të pres një rikthim të arsyeshëm të investimit të tij në instalimin e **pajisjes të matjes** siç përcaktohet nga **Rregullatori** në **tarifën e qasjes në rrjet** dhe që **Operatori i Sistemit** dhe **përdoruesi i sistemit** në përgjithësi duhet të mbrohen nga pagesa për ndërrime të shpeshta të **pajisjes të matjes** të instaluar në objektet e çdo **përdoruesi të sistemit**.

## 7.2.2 Regjistrimi i sistemeve matëse që nuk janë plotësisht në pajtueshmëri

7.2.2.1 **Operatori i Sistemit** duhet të mirëmbajë regjistrin e të gjitha grupeve (sistemeve) matëse që nuk janë plotësisht në pajtueshmëri me kërkesat e këtij kodi, me rregulloret e tjera dhe me kërkesat tarifore të përdoruesit të sistemit. Ky regjistër do të përfshijë detaje të të gjitha mangësive të grupit (sistemit) matës.

7.2.2.2 Deri në datën 1 shkurt të çdo viti një raport i detajuar i gjithë mangësive të grupit (sistemit) matës duhet të përgatitet nga **Operatori i Sistemit** dhe duhet t'i dorëzohet **Operatorit të Tregut** i cili do të bëjë rekomandime për **Zyrën e Rregullatorit për Energji** në lidhje me vazhdimin e shërbimit të grupeve (sistemeve) matëse me mangësi. **Zyra e Rregullatorit për Energji** do ta rishikoj raportin dhe do të përcaktoj nëse përdorimi në vazhdim i grupit (sistemit) matës duhet të lejohet përtej datës 1 shkurt të vitit të ardhshëm. **Zyra e Rregullatorit për Energji** do të udhëzoj **Operatorin e Tregut** dhe **Operatorin e Sistemit** sipas nevojës.

7.2.2.3 Në mënyrë që grupet (sistemet) matëse të arrijnë standardin e kërkuar nga ky kod dhe rregulloret e tjera në faza kohore, **Operatori i Sistemit** do të krijoj një program të përmirësimit të matjes për të siguruar që:

- Në rast se **grupet (sistemet) matëse** nuk i plotësojnë kërkesat e rregullave dhe rregulloreve të aplikueshme në datën e instalimit të tyre të parë, ato duhet t'i plotësojnë standardet e kërkuara brenda një viti nga momenti kur bëhet e dukshme mangësia.
- Në rast se **grupet (sistemet) matëse** kanë plotësuar kërkesat e rregullave dhe rregulloreve të aplikueshme në datën e instalimit të tyre të parë, ato duhet t'i plotësojnë standardet brenda periudhave të caktuara në seksionin 7.2.2.4.

7.2.2.4 Aty ku **konsumatorët e kualifikuar** janë të detyruar nga çertifikata e kualifikimit e lëshuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji** për tu pajisur me grup (sistem) matës ose grupe (sisteme) matëse në pajtueshmëri me kërkesat e këtij kodi, ato duhet të instalohen brenda afatit kohor të përcaktuar në çertifikatën e kualifikimit të lëshuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji**.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 18 nga 42</i>

### 7.2.3 Periudhat e përmirësimit

7.2.3.1 Të gjithë njehsorët që nuk plotësojnë kërkesat e këtij kodi dhe ndonjë rregulloreje tjetër ekzistuese, por që plotësonin kërkesat në fuqi në datat e vënies së tyre të parë në punë duhet të zëvendësohen me njehsorë që i plotësojnë kërkesat në fund të periudhës së tyre të verifikimit.

7.2.3.2 Nëse, në datën në të cilën ky kod miratohet nga **Zyra e Rregullatorit për Energji**, matësit që plotësonin kërkesat në fuqi në datën e vënies së tyre të parë në punë, nuk i plotësojnë kërkesat e reja dhe janë jashtë periudhës së verifikimit të tyre, ato duhet të zëvendësohen me matës që i plotësojnë kërkesat brenda një periudhe pesë vjeçare. **Operatori i Sistemit** duhet të pajtohet me **Zyrën e Rregullatorit për Energji** rreth një programi korrigjues në faza kohore, të tillë që në çdo vit të periudhës përmirësuese të instalohen një numër afërsisht i njëjtë i sistemeve matëse.

7.2.3.3 Nëse matësit nuk ekzistojnë atëherë duhet të instalohen matësit që i plotësojnë kërkesat brenda një periudhe një vjeçare.

7.2.3.4 Nëse **TMRR** dhe **TMT** nuk i plotësojnë kërkesat e këtij kodi dhe rregulloreve të tjera, por plotësonin kërkesat në fuqi në datën e vënies së tyre të parë në punë dhe zëvendësimi i tyre do të kërkojë zëvendësimin e një njësie të madhe të stabilimentit, atëherë ata mund të vazhdojnë të përdoren derisa ajo njësi e stabilimentit kryesor të zëvendësohet. Në këtë pikë edhe **TMRR** dhe **TMT** relevante duhet të zëvendësohen me pajisje që janë në pajtueshmëri me këtë kod.

7.2.3.5 Nëse **TMRR** dhe **TMT** nuk i plotësojnë kërkesat e këtyre rregullave ose rregulloreve të tjera por plotësonin kërkesat në fuqi në datën e vënies së tyre të parë në punë dhe zëvendësimi i tyre nuk do të kërkonte zëvendësimin e një njësie të madhe të stabilimentit kryesor, atëherë ata duhet të zëvendësohen me pajisje matëse që i plotësojnë kërkesat brenda një periudhe pesë vjeçare (nga data e miratimit të këtij kodi nga **Zyra e Rregullatorit për Energji**). **Operatori i Sistemit** dhe **Zyra e Rregullatorit për Energji** kërkohet të pajtohen për një program korrigjimi në faza kohore të tillë që në secilin vit të periudhës përmirësuese afërsisht një numër i barabartë i grupeve (sistemeve) matëse do të plotësonin kushtet nëpërmjet zëvendësimit të **TMRR** dhe **TMT** të tyre.

### 7.2.4 Vlerësimi gjatë periudhave përmirësuese

7.2.4.1 Nëse është e nevojshme të vlerësohet konsumi i energjisë në një **pikë të kyçjes** që është objekt i dispozitave të planifikuara të përmirësimit sipas seksionit 7.2.2.4 atëherë një vlerësim i tillë do të kryhet në përputhje me Rregullat e Tregut.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 19 nga 42</i>

## 7.2.5 Përjashtimet

7.2.5.1 Aty ku **Operatori i Sistemit** është i aftë t'i demonstroj në mënyrë të kënaqshme **Zyrës së Rregullatorit për Energji**, se një sistem matës që nuk i plotëson të gjitha kërkesat e këtij kodi, por plotëson:

- a) kërkesat e të gjitha rregulloreve të tjera dhe kërkesat e seksionit 8.2.3.2 dhe 10,
- b) kërkesat e tarifave të **përdoruesit të sistemit**, dhe
- c) është brenda periudhës së tij të verifikimit,

atëherë **grupi (sistemi) matës** mund të mbetet në shërbim pa modifikim deri në fund të periudhës së verifikimit ose derisa të ndërmerren punime të mëdha në **grupin (sistemin) matës**, cilado që të ndodhë më herët.

## 8 Grupet (sistemet) matëse

### 8.1 Kërkesat minimale për matje

8.1.1.1 Të gjitha **pikat e furnizimit** do të kërkojnë si minimum të kenë një matës pa intervale që do të mund të regjistronte **energjinë aktive** dhe do të inkorporonte një ekran që tregon totalin e integruar.

8.1.1.2 Aty ku kërkohet të plotësohen kërkesat e tarifës së qasjes në rrjet të aplikueshme në pikën e furnizimit, do të instalohen gjithashtu matësit që regjistrojnë energjinë reaktive.

8.1.1.3 Matësit me intervale do të instalohen:

- a) Në pikat kyçëse mes **Sistemit të Transmisionit** të vënë në funksionim nga Operator të ndryshëm të Sistemit dhe pikat kyçëse mes **Sistemeve të Transmisionit** dhe **Sistemeve të Shpërndarjes**,
- b) Në pikat kyçëse mes **Sistemeve të Shpërndarjes** të vënë në funksionim nga **Operatorët e Sistemeve** të ndryshëm,
- c) Në **pikat e kyçjes së njërive gjeneruese** aty ku **prodhimi** dëshiron të jetë i paguar për energjinë që ata dërgojnë në **Sistemin Energjetik publik**,
- d) Në **pika furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar** të cilët zgjedhin **furnizuesin** e vet (ende jo obligative),, dhe
- e) Në çdo pikë tjetër furnizimi ku **Zyra e Rregullatorit për Energji** mendon së është e nevojshme të instalohet **njehsori me intervale**.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 20 nga 42</i>

- 8.1.1.4 Përdoruesit e sistemit që funksionojnë vetëm brenda Kosovës dhe janë të detyruar të pajisen me matës me intervale, duhet t'i vendosin matësit, aty ku intervali është periudha e barazimit përfundimtar e përcaktuar nga Rregullat e Tregut. Përdoruesit e Sistemit, rrjetet e të cilëve kyçen me rrjete të tjera jashtë Kosovës ose tregtojnë energji me ndërmarrje jashtë Kosovës duhet të pajisen me matës aty ku intervali është më i shkurti i periudhës së barazimit përfundimtar të vendosur nga Rregullat e Tregut dhe periudhës së barazimit përfundimtar të vendosur nga ENTSO-E për të plotësuar kërkesat e barazimit përfundimtar në tregun rajonal ose në rastet kur një periudhë e tillë nuk është e caktuar në një periudhë prej 15 minutash.
- 8.1.1.5 Matja me intervale duhet të mas, regjistroj dhe ruaj informacionin e transferimit të energjisë për secilën periudhë të barazimit përfundimtar dhe të jetë i aftë për ekzaminimin nga distanca dhe në vend. Të dhënat e ruajtura të matësve me intervale duhet të kenë një minimum prej 45 ditësh informacion për secilën periudhë të barazimit përfundimtar. Kërkesat e detyrueshme për klasa të ndryshme kyçjesh janë detajuar në seksionet e mëposhtme. Këto të dhëna mund të mbahen në një grumbullues të dhënash që është brenda të njëjtës kuti me matësin ose si një njësi e veçantë.
- 8.1.1.6 Të gjitha pajisjet e matjes duhet të jenë të një modeli të miratuar nga ministria me anë të lëshimit të një lloj çertifikate miratuese në përputhje me seksionin 11.2. Të gjitha sistemet matëse duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet relevante teknike të specifikuar në seksionin 8.2.1.2 dhe të plotësojnë kërkesat e klasës së saktësisë të detajuara në seksionin 8.3.2.

## **8.2 Matjet e fuqisë dhe energjisë elektrike**

- 8.2.1.1 Pajisjet matëse të instaluar në secilën pikë të kyçjes do të masin, regjistrojnë dhe ruajnë matjet e fuqisë dhe energjisë elektrike të paraqitura në tabelën e mëposhtme të cilat kërkohen për qëllime të barazimit përfundimtar dhe qasjes në rrjetë.

Matjet e fuqisë dhe energjisë elektrike	Importi KW dhe KWh	Eksporti KW dhe KWh	Energjia Reaktive (Dhënje) kVAr dhe kVArh	Energjia Reaktive (Marrje) kVA dhe kVArh	Matësi me intervale
<b>Pikat Kyçëse mes Sistemeve të Transmisionit dhe Sistemeve të tjera</b>	Po	Po	Po	Po	Po
<b>Pikat Kyçëse mes Sistemeve të Shpërndarjes</b>	Po	Po	Po	Po	Po
<b>Njësitë gjeneruese</b>	Po	Po	Po	Po	Po
<b>Pikat ffurnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – 1MW dhe më tepër</b>	Po	Jo	Po	Po	Po
<b>Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – më e ulët se 1MW</b>	Po	Jo	Po *	Jo	Po
<b>Pika të tjera furnizuese</b>	Po *	Jo	Po *	Jo	Jo

\* në rastin e këtyre pikave furnizuese, matja dhe regjistrimi i KW, kVAr dhe kVArh është i nevojshëm vetëm nëse kërkohet nga tarifa e duhur e qasjes në rrjet në pikën e furnizimit.

8.2.1.2 Pajisjet e matjes do të instalohen në **pikën e kyçjes** mes rrjeteve të Operatorëve të Sistemit të ndryshëm ose në **pikën e kyçjes** mes rrjetit të një **Operatori të Sistemit** dhe atij të përdoruesit të sistemit.

8.2.1.3 Aty ku nuk është praktike të instalohen pajisjet e matjes në kufijtë mes rrjeteve ashtu siç detajohen në seksionin 8.2.1.2, pajisjet e matjes do të instalohen sa më afër që të jetë praktike me kufirin e rrjetit dhe faktorët e korrjimit të dakorduar mes palëve përgjegjëse për rrjetet e secilës anë të **pikës së kyçjes** dhe **Operatorit të Sistemit**. Në rast se palët nuk pajtohen rreth faktorëve të duhur të korrjimit, çështja duhet t'i referohet procesit të zgjidhjes së kontesteve (mosmarrëveshjeve).

8.2.1.4 Aty ku faktorët e korrigjimit aplikohen, do të aplikohen kudo që të jetë e mundur tek matësit në mënyrë që të dhënat e paraqitura në regjistrin e matësit të reflektojnë detyrimet e palëve. Aty ku nuk është e mundur të aplikohen faktorët e korrigjimit në matës ata mund të aplikohen mbi të dhënat matëse ose në ndonjë grumbullues të të dhënave jashtë stacionit të lidhur me matësin ose në qendrën e të dhënave nga distanca (RDC).

8.2.1.5 Një gjendje e përdorimit të matësve kryesor dhe kontrollues për matjen e energjisë do të vihen në punë në të gjitha pikat e kyçjes, ku transferimi i energjisë elektrike është i madh dhe me rëndësi të veçantë për procesin e **barazimit përfundimtar** me çka do të sigurohen të **dhëna matëse** të sakta dhe ato do të jenë në dispozicion për këtë qëllim.

8.2.1.6 Njehsorët (matësit) kryesor dhe kontrollues do të instalohen ashtu siç parashtrohet në tabelën e mëposhtme që gjithashtu tregon se ku duhet të vendosen **TMRR** dhe **TMT** të veçanta për të vënë në punë njehsorin (matësin) kryesor dhe njehsorin (matësin) kontrollues:

Përdorimi i matësve kryesor dhe kontrollues	Matësi kryesor	Matësi kontrollues	TMRR i veçantë	TMT i veçantë
<b>Pikat Kyçëse mes Sistemit të Transmisionit dhe sistemeve të tjera</b>	Po	Po	Po	Po
<b>Pikat Kyçëse mes Sistemeve të Shpërndarjes</b>	Po	Po	Po	Jo
<b>Njësitë gjeneruese</b>	Po	Po	Po	Po
<b>Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – 1MW dhe më tepër</b>	Po	Po	Po	Jo
<b>Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – më e ulët se 1MW</b>	Po	Jo	Jo	Jo
<b>Pika të tjera furnizuese</b>	Po	Jo	Jo	Jo

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 23 nga 42</i>

Aty ku **TMRR** ose **TMT** kërkohen ndaras, do të jetë e mjaftueshme të pajisen **TMRR**-të ose **TMT**-të me bobina (pështjella) dytësore të ndara, por bobina (pështjella) primare është e përbashkët.

8.2.1.7 Aty ku më tepër se një **TMT** i përshtatshëm ekziston dhe në rastin e humbjes së furnizimit nga njëri **TMT**, duhet të instalohet një aranzhim komutues në mënyrë që të jetë në dispozicion një tension referent. Aty ku kërkohet **TMT** i veçantë për të plotësuar kërkesat e seksionit 8.2.1.5, aranzhimi komutues për secilën prej matësve kryesor dhe kontrollues duhet të synojë drejt **TMT** -ve të ndryshëm.

8.2.1.8 Tek **TMT** referente të sistemeve matëse, aq sa të jetë e mundur, duhet të instalohen siguresa sa më afër pikave fundore të bobinës (pështjellës) sekondare. Aty ku aplikohen ngarkesa të tjera në bobinat (pështjellat) sekondare në përputhje me dispozitat e seksionit 8.2.2.7, matja dhe ngarkesat e tjera duhet të instalohen ndaras.

8.2.1.9 Aty ku matësit kryesor dhe kontrollues ndajnë të njëjtën referencë të tensionit dhe kabloja (teli) që del nga siguresat e montuara në терминаlet e **TMT** deri tek matësi është më i gjatë se 30 metra, andaj tensioni referent për matësit kryesor dhe kontrollues do të mbrohet me siguresa të ndara dhe sa më afër terminaleve të **TMT** që të jetë praktike.

8.2.1.10 Të dhënat matëse të mbledhura nga matësit kryesor nuk do të merren parasysh dhe të dhënat e mbledhura nga matësit kontrollues do të përdoren në vend të tyre në situatat e detajuara në Rregullat e Tregut. Aty ku ka ndryshime përtej kufijve normal të saktësisë mes vlerave të regjistruara nga matësit kryesor dhe kontrollues, arsyeja e këtyre diferencave do të shqyrtohet nga **OS** i cili do të rekomandoj masat që do të merren në përputhje me Rregullat e Tregut.

8.2.1.11 Një përdorues i sistemit do të ketë të drejtën të kërkojë që një ekspert i emëruar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji** të shqyrtojë ndryshimin në vlera aty ku përdoruesi i sistemit nuk pajtohet me vendimin e **Operatorit të Sistemit** pas rishikimit të ndërmarrë në përputhje me seksionin 8.2.1.10

8.2.1.12 Aty ku nuk kërkohet që të dy matësit fizik të regjistrojnë të njëjtin lloj të dhënash do të jetë e lejueshme që të dhënat të regjistrohen ose nga matësi kryesor ose nga matësi kontrollues. Aty ku është praktike, të dhënat matëse, regjistrimi i të cilave nuk kërkohet

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 24 nga 42</i>

të dyfishohet, duhet të ndahen mes matësve të grupit (sistemit) matës në mënyrë të tillë që të minimizohet shuma e të dhënave të humbura në rastin e prishjes së një pajisje të vetme.

## 8.2.2 Specifikimet teknike të pajisjeve të matjes

- 8.2.2.1 Pajisjet e matjes do të jenë të sakta brenda kufijve të përshkruar për pajisje të matjeve të tilla, të cilëve iu referohet ose i përcakton ky **Kod i Matjes**.
- 8.2.2.2 Të gjithë matësit e energjisë aktive duhet të përmbushin kërkesat e IEC 60687 ose IEC 61036 dhe pjesët relevante të IEC 62053
- 8.2.2.3 Të gjithë matësit e energjisë reaktive duket të përmbushin kërkesat e IEC 61268 dhe pjesët relevante të IEC 62053.
- 8.2.2.4 Të gjithë matësit do të etiketohen me një identifikues unik dhe ky informacion së bashku me detajet dhe specifikimet teknike duhet të regjistrohet nga **Operatori i Sistemit**.
- 8.2.2.5 Të gjithë **transformatorët matës të tensionit (TMT)** dhe **transformatorët matës të rrymës (TMRR)** duhet të plotësojnë kërkesat e pjesëve relevante të IEC 60044.
- 8.2.2.6 Ngarkesa totale e bobinave (pështjellave) sekondare të një **TMT** ose **TMRR** nuk duhet në asnjë rrethanë ta kalojë ngarkesën nominale të asaj bobine (pështjelle).
- 8.2.2.7 Aty ku është praktike, bobinat (pështjellat) sekondare të **TMT** dhe **TMRR** të përdorura për qëllime matëse duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllime matëse, megjithëse do të jetë e lejueshme të ndahet përdorimi i bobinave (pështjellave) me pajisje të tjera nëse kërkesat e seksioneve 8.2.2.6, 8.2.3.2 dhe 9 janë përmbushur dhe është marrë miratimi i **Operatorit të Tregut**. Sapo të jetë dhënë miratimi për përdorim të përbashkët nuk do të lejohet ndryshimi i ngarkesës në ndonjërin nga bobinat (pështjellat) e **TMRR** dhe **TMT** pa marrë përsëri miratimin e **Operatorit të Tregut**.

## 8.2.3 Transformatorët ekzistues të matjes

- 8.2.3.1 Aty ku qarqet, përveç atyre që janë instaluar të reja, duhet të maten në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut dhe këtë Kod të Matjes, dhe aty ku transformatorët matës të instaluar nuk janë plotësisht në pajtueshmëri me kërkesat e këtij seksioni 8.2.1.12 dhe të seksionit 8.3.2.1 atëherë këta transformatorë matës mund të vazhdojnë të përdoren nëse përmbushin kërkesat e mëposhtme dhe ato në seksionet 8.2.2.7 dhe 8.2.3.2.



	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 25 nga 42</i>

8.2.3.2 Aty ku si pasojë kryhet një ndërrim i madh në stabilimentin primar, duhet të sigurohen transformatorë matës të rinj që plotësojnë kërkesat e plota të këtij Kodi të Matjes.

### 8.3 Saktësia e pajisjeve të matjes

8.3.1.1 Kufijtë e lejueshëm të gabimit për grupet (sistemet) matëse që regjistrojnë energjinë aktive do të jenë:

Saktësia Matëse	Rryma (relative me rrymën nominale)	Faktori i Fuqisë	Kufiri i Gabimit
<b>Kyçjet mes Sistemit të Transmisionit dhe sistemeve të tjera dhe Njësitë gjeneruese - 100MW dhe më tepër</b>	120% deri në 10%	1	± 0.5%
	Më pak se 10% deri në 5%	1	± 0.7%
	Më pak se 5% deri në 1%	1	± 1.5%
	120% deri në 10%	0.8 marrje	± 1.0%
0.5 dhënje		± 1.0%	
<b>Pikat Kyçëse mes sistemeve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – më tepër se 10 MW</b>	120% deri në 10%	1	± 1.0%
	Më pak se 10% deri në 5%	1	± 1.5%
	Më pak se 5% deri në 1%	1	± 2.5%
	120% deri në 10%	0.8 marrje	± 2.0%
0.5 dhënje		± 2.0%	
<b>Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale - mes 1MW dhe 10MW</b>	120% deri në 10%	1	± 1.5%
	Më pak se 10% deri në 5%	1	± 2.0%
	120% deri në 10%	0.8 marrje	± 2.5%
		0.5 dhënje	± 2.5%

Saktësia Matëse	Rryma (relative me rrymën nominale)	Faktori i Fuqisë	Kufiri i Gabimit
<b>Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – më e ulët se 1MW</b>	120% deri në 20%	1	± 1.5%
	Më pak se 20% deri në 5%	1	± 2.5%
	120% deri në 10%	0.8 marrje	± 2.5%
		0.5 dhënje	± 2.5%
<b>Pika të tjera furnizuese</b>	100% deri në 5%	1	± 2.5%

8.3.1.2 Kufijtë e lejueshëm të gabimit për grupet (sistemet) matëse që regjistrojnë energjinë reaktive do të jenë:

Saktësia e përgjithshme matëse	Rryma (relative me rrymën nominale)	Faktori i Fuqisë	Kufiri i Gabimit
<b>Të gjitha pikat kyçese mes rrjeteve, Njësitë gjeneruese, dhe Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – 1MW dhe më tepër</b>	120% deri në 10%	0	± 4.0%
	120% deri në 20%	0.87 dhënje	± 5.0%
		0.87 marrje	± 5.0%
		0.87 marrje	± 5.0%
<b>Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – më e ulët se 1MW, dhe Pika të tjera furnizuese – ku kërkohet nga tarifa e qasjes në rrjetë</b>	100% deri në 20%	0	± 5.0%
	100% deri në 20%	0.87 dhënje	± 5.0%
		0.87 marrje	± 5.0%

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 27 nga 42</i>

### 8.3.2 Klasa e Saktësisë së Pajisjeve të Matjes

8.3.2.1 Klasa e saktësisë për pajisjet e matjes të instaluara do të jetë:

Saktësia e Pajisjeve Matëse	Njehsorët Aktiv	Njehsorët Reaktiv	TMRR	TMT
<b>Pikat Kyçëse mes Sistemeve të Transmisionit dhe sistemeve të tjera dhe Njësitë gjeneruese - 100MW dhe më tepër</b>	0.2S	2.0	0.2S	0.2
<b>Pikat Kyçëse mes Sistemeve të Shpërndarjes Njësitë prodhuese më të vogla se 100MW dhe Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – 10MW dhe më tepër</b>	0.2S	2.0	0.2S	0.5
<b>Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – 1MW dhe më tepër</b>	0.5	3.0	0.5	1.0
<b>Pikat furnizuese të konsumatorëve të kualifikuar dhe pikat furnizuese ku Rregullatori përcakton se nevojitet matja me intervale – më e ulët se 1MW</b>	1.0	3.0	0.5	1.0
<b>Pika të tjera furnizuese</b>	2.0	3.0	0.5	-

### 8.4 Kërkesat për të dhënat e matësve me intervale

#### 8.4.1 Ruajtja e të dhënave

8.4.1.1 Të dhënat matëse për njehsorët me intervale do të ruhen në **pikën e matjes** siç është përcaktuar në seksionin 8.1.1.4. Të dhënat e transmetuara nga grumbulluesi i të dhënave për tek qendra e të dhënave në distancë (RDC) duhet të jetë në një format dhe protokoll që mbështetet nga Qendra e të dhënave nga distanca (RDC).

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 28 nga 42</i>

8.4.1.2 Grumbulluesit e të dhënave do të ekzaminohen normalisht dhe të dhënat e matura do të mbledhen nga Qendra e të dhënave nga distanca (RDC) në baza ditore. Megjithatë mbledhje të përsëritura të të dhënave matëse do të jenë të mundura gjatë gjithë periudhës së mbledhjes së të dhënave të grumbulluesit të të dhënave. Asnjë operim 'leximi' nuk do të fshijë apo ndryshojë ndonjë nga të dhënat e matura të ruajtura. Një grumbullues të dhënash do të ofrojë çdo pjesë të të dhënave të ruajtura me kërkesë të Qendrës të të dhënave nga distanca (RDC).

8.4.1.3 Grumbulluesit e të dhënave do të lëshojnë një sinjal alarmi të jashtëm në Qendrën e të dhënave nga distanca (RDC) në rastin e një defekti në furnizimin me energji. Për t'u kujdesur për defektet e vazhdueshme në furnizim, ora, kalendari dhe të gjitha të dhënat do të mbahen për një periudhë prej 45 ditësh pa një lidhje me furnizim të jashtëm.

#### 8.4.2 Kohëmatja

8.4.2.1 Kërkesat e kohëmatjes së Qendrës së të dhënave nga distanca (RDC) dhe të grupeve (sistemeve) matëse lokale do të detajohen në paragrafët në vazhdim.

8.4.2.2 Të gjitha periudhat e matura të barazimit përfundimtar do të lidhen me pikën kohore 00:00:00 në përputhje me standardin kohor kombëtar.

8.4.2.3 Sinkronizimi kohor i Qendrës së të dhënave nga distanca (RDC) do të kryhet vetëm nëpërmjet një receptori të integruar dhe radio sinjali të sinkronizuar dhe sinkronizimi do të ndërmerret çdo gjashtë orë.

8.4.2.4 Aty ku përdoren pajisje portable (të transferueshme) nga Qendra e të dhënave nga distanca (RDC) për të mbledhur të dhëna nga një grumbullues të dhënash në rastin e një defekti në komunikim, sinkronizimi kohor i pajisjeve të transferueshme do të kryhet nëpërmjet një receptori të integruar dhe një radio sinjali të sinkronizuar ose me një sinjal reference të sinkronizuar nga sistemet kryesore të Qendrës së të dhënave nga distanca (RDC). Sinkronizimi kohor duhet të kryhet menjëherë para ose pasi është përdorur për të mbledhur të dhëna ose, nëse këto ndodhi janë të ndara me më tepër se 24 orë, të paktën njëherë në çdo 24 orë.

8.4.2.5 Sinkronizimi kohor i grumbulluesit të të dhënave duhet të kryhet nëpërmjet një receptori të integruar dhe një radio sinjali të sinkronizuar ose me një sinjal reference të sinkronizuar nga Qendra e të dhënave nga distanca (RDC). Pajisjet për sinkronizim kohor të grumbulluesit të të dhënave nëpërmjet një receptori të integruar dhe një radio sinjali të sinkronizuar do të vendosen në **pikat e kyçjes** në **Sistemin**

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 29 nga 42</i>

**Transmetues** dhe në **pikat e kyçjes** së gjenerimit dhe mund të vendosen edhe në **pikat kyçëse** të tjera.

8.4.2.6 Në secilin rast që sistemet e **RDC** kërkojnë të dhëna nga një grumbullues të dhënash, koha e regjistruar nga grumbulluesi i të dhënave do të kontrollohet kundrejt kohës së regjistruar nga sistemet e **RDC** dhe, nëse diferenca është më e madhe se 2 sekonda dhe më e vogël se 10 minuta atëherë sistemet **RDC** do ta korrigjojnë kohën e regjistruar nga grumbulluesi i të dhënave. Aty ku diferenca e kohës është më e madhe se 10 minuta, koha e regjistruar nga grumbulluesi i të dhënave nuk do të korrigjohet dhe të dhënat e mbledhura nuk do të përpunohen derisa të hetohet shkaku i mospërputhjes dhe të kuptohet efekti i mospërputhjes në mbledhjen e të dhënave.

### 8.4.3 Monitorimi i Pajisjeve

8.4.3.1 Monitorimi i pajisjeve do të ofrohet për secilën nga situatat e mëposhtme:

- a) Defekt në funksionalitetin e **grumbulluesit të të dhënave**,
- b) Ecje (rrotullimi) prapa i diskut të matësit (nëse është e mundshme),
- c) Monitorimi i baterisë dhe i furnizimit me energji,
- d) Kontrollimi i memories,
- e) Problemi i furnizimit të **TMT**,
- f) Qasje në portin lokal të marrjes së të dhënave.

8.4.3.2 Secili nga defektet e mësipërme do të raportohet nga minimum një alarm i zakonshëm tregues kur të dhënat tërhiqen nga **RDC** dhe kur ka qasje në portin lokal të marrjes së të dhënave. Alarmi duhet të etiketohet për periudhën e përshtatshme të **barazimit përfundimtar**.

### 8.4.4 Pajisjet e komunikimit

8.4.4.1 Secili **grumbullues i të dhënave** do të përmbajë pajisjet lokale dhe në distancë të tërheqjes së të dhënave nga porte të veçanta.

8.4.4.2 **Pajisjet e matjes** do të instalohen në mënyrë të atillë që edhe leximi edhe ri-programimi i të dhënave matëse të mbajtura nga **grupi (sistemi) matës** të jenë të mundura nëpërmjet qasjes lokale ose në distancë në një nivel të përshtatshëm sigurie kontrolluar nga (pasvordet) fjalëkalimet e duhura.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 30 nga 42</i>

#### 8.4.5 Marrja e të dhënave lokale

8.4.5.1 Një port për marrjen e të dhënave do të ndodhet në secilin grumbullues të të dhënave për të lejuar një terminal të dhënash lokale si për shembull një kompjuter laptop për t'u lidhur për arsyet e mëposhtme:

- a) Vënia në punë, mirëmbajtja dhe gjetja e gabimeve,
- b) Transferimi i të dhënave të matura në rastin e një defekti në komunikacion, dhe
- c) Rregullimi i kohës kur kjo nuk mund të kryhet në distancë ose automatikisht.

#### 8.4.6 Marrja e të dhënave në distancë

8.4.6.1 Secili **grumbullues i të dhënave** do të pajiset me një interface të brendshëm ose të jashtëm komunikimi siç është modemi ose radio transmetuesi që mbështet shkëmbimin e të dhënave për kërkesa lokale apo në distancë në përputhje me IEC 61107 ose pjesët relevante të IEC 62056. Një lidhje komunikimi do të sigurohet për të lejuar marrjen e të dhënave të matjes nga **RDC**. Kjo lidhje mund të përdoret po ashtu nga **Operatori i Sistemit** për arsye normale të lidhura me vënien në funksionim, mirëmbajtjen dhe hetimin e gabimeve në lidhje me **grupin (sistemin) matës**.

8.4.6.2 Linja e komunikimit mund të vendoset duke përdorur qarqe të dedikuara ose me dial-up, por nuk lejohet që të dhënat matëse të kalojnë nëpërmjet ndonjë sistemi TI ku të dhënat mund të manipulohen gjatë tranzitit për në **RDC**.

### 9 Të dhënat matëse dhe mbledhja e të dhënave në distancë

#### 9.1 Baza e të dhënave matëse

9.1.1.1 Secili **Operator i Sistemit** do të vendosë një bazë të dhënash të të gjitha pikave të kyçjes në rrjetin e tij. Për secilën **pikë kyçje**, kjo bazë e të dhënave do të regjistrojë (në mënyrën e plotësimit të vendeve boshe ose duke përdorur kode të standardizuara të dhënave) të gjitha të dhënat e përshtatshme të listuara:

- a) Identifikues unik për **pikat e kyçjes**,
- b) Furnizuesi,
- c) **Matja në intervale/jo-intervale**,
- d) Klasa e saktësisë,
- e) Tensioni i lidhjes
- f) Gjendja e **energjisimit**,

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 31 nga 42</i>

- g) Data e leximit të fundit,
- h) Leximi i fundit grumbullues i energjisë aktive,
- i) Leximi i fundit grumbullues i energjisë reaktive dhënje,
- j) Leximi i fundit grumbullues i energjisë reaktive marrje,
- k) Kërkesa maksimale mujore më e lartë në dymbëdhjetë muajt e fundit,
- l) Prodhuesi i **matësit**,
- m) Modeli i **matësit**,
- n) Klasa e saktësisë së **sistemit matës**,
- o) Data dhe ora e instalimit ose de-instalimit,
- p) Data e verifikimit,
- q) Data e ri-verifikimit,
- r) Data e testimit të fundit,
- s) Data e testimit pasues,
- t) Klasat e saktësisë të **TMRR** dhe **TMT**,
- u) Vendndodhja e të dhënave të defekteve të **TMRR** dhe **TMT**.

9.1.1.2 Të dhënat e leximit të matësve të cilat do të mbahen në bazën e të dhënave matëse do të jenë:

- a) Parapagimet e matësve dhe të dhënat e periudhave matëse që kërkohen për **barazimin përfundimtar**,
- b) Njoftimin e fundit për shfrytëzimin e leximit e të dhënave plus kohën dhe datën në të cilën janë lexuar,
- c) Njoftimin e fundit për shfrytëzimin e leximit të të dhënave të konfirmuara nga **Operatori i Sistemit** plus kohën dhe datën në të cilën janë lexuar,
- d) Diferenca e llogaritur nga njoftimi paraprak për shfrytëzimin e leximit të të dhënave të konfirmuara nga **Operatori i Sistemit** plus kohën dhe datën ndërmjet të cilave shfrytëzimi i leximit ka ndodhur.

9.1.1.3 **Operatori i Sistemit** do të jetë i lirë të përcaktojë nëse të dhënat fikse të matjes dhe leximi i të dhënave të matësit duhet të mbahen në një ose më tepër se një bazë të dhënash.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 32 nga 42</i>

9.1.1.4 **Operatori i Sistemit** duhet të krijojë masa të përshtatshme në përputhje me provizionet e seksionit 10.4, Rregullat e Tregut dhe rregullore të tjera për të mbrojtur të dhënat nga qasjet e paautorizuara ose ndryshimet.

## 10 Siguria e grupeve (sistemeve) të matjes

### 10.1 Vendndodhja e aparaturave

10.1.1.1 Mënyra e vetme e mundshme për t'i siguruar **sistemet e matjes** nga dëmtimi fizik është nëse ato instalohen në një vend të përshtatshëm.

10.1.1.2 Vendi i zgjedhur për instalimin e **grupeve (sistemeve) matëse** duhet në të gjitha rastet të jetë:

- a) i mbrojtur nga hyrja e personave të paautorizuar, e kafshëve ose insekteve që mund të shkaktojnë dëmtime,
- b) larg nga materialet e djegshme në një distancë prej 1.5 metrash në të gjitha drejtimet,
- c) i mundshëm lehtësisht për hyrjen e përfaqësuesve të **Operatorit të Sistemit** nga pika në të cilën ata hyjnë për në pronë, dhe
- d) përveç rasteve që aparaturat janë caktuar për t'u vendosur jashtë, ambienti duhet të qëndrojë i pastër dhe i thatë.

### 10.2 Pllombimi i aparaturave matëse

#### 10.2.1 E përgjithshme

10.2.1.1 Përveç pllombës së kalibrimit e cila vendoset nga organizata përgjegjëse për kalibrimin e matësit, pllombat e instalimit duhet të vendosen për të siguruar zbulimin e ndërhyrjeve të mundshme në paprekshmërinë e **pajisjeve matëse**.

10.2.1.2 Të gjitha **pajisjet matëse** do të pllombohen pas energjizimit fillestar dhe do të ripllombohen pas çdo ndërhyrje të mëvonshme e cila kërkon heqjen e pllombave. Për të siguruar që vulat e vjetra nuk mund të rivendosen në aparatura në mënyrë të atillë që të fshehin ndërhyrjet e paautorizuara, të gjitha pllombat e vjetra do të hiqen nga vendi dhe do të asgjësohen nga **Operatori i Sistemit** përgjegjës për heqjen e tyre.

10.2.1.3 Në këtë kontekst, qëllimi është që të gjithë kapakët e terminalëve të matësve, kapakët e bllokut testues, siguresat ndihmëse dhe lidhëse, relet të përdoren për të kontrolluar vlerat e tarifave, blloqet lidhëse, kapakët e porteve komunikuese, mbulesat e terminaleve **TMRR** dhe **TMT**. Aty ku një numër i këtyre komponentëve ndodhen në



	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 33 nga 42</i>

një kabinet të vetëm, mund të jetë e lejueshme të pllombohen kapakët e atij kabineti në vend të pllombimit të secilës komponent të veçantë.

### 10.2.2 Forma e pllombës

- 10.2.2.1 Një pllombë instalimi duhet të përbëhet nga dy pjesë – një pjesë e shkurtër teli dhe një pjesë tjetër e fortë plastike pllombuese – të cilat kur lidhen së bashku dhe mbyllen, do të parandalojnë heqjen e pllombës pa një shenjë të qartë të kësaj heqje. Specifikimi i mëposhtëm për pllombën ka për qëllim të sigurojë që nuk mund të thyhet apo hiqet në mënyrë të arsyeshme aksidentale pa u hetuar.
- 10.2.2.2 Teli duhet të jetë 150 mm i gjatë, të ketë një diametër minimal prej 0.9 mm, të ketë një ngarkesë të thyerjes prej të paktën 880N dhe të jetë punuar nga 7 fije teli prej çeliku të veshur me zink.
- 10.2.2.3 Pjesa plastike e pllombës duhet të jetë në formë katrori, ku pjesa e poshtme e pllombës duhet të ketë formë rrethore, me dimensione ndërmjet 2.0 x 2.5 cm deri në 2.5 x 3.0 cm, me një diametër ndërmjet 5.0 dhe 8.0 mm, dhe mund të ndërtohet në mënyrë të tillë që në asnjë pikë gjerësia e pllombës nuk është më e vogël se 0.8 mm.
- 10.2.2.4 Secila pllomb duhet të identifikohet me numër të vet serik, numër ky i cili duhet të jetë i dukshëm dhe të figuroj në njërin nga të dy anët e pjesës plastike të pllombës. Përmes numrit serik të pllombës do të jetë më e lehtë referimi në shënimet përkatëse që kanë të bëjnë me datën dhe kohën e instalimit, vendin e instalimit, pastaj datën dhe kohën e demontimit, arsyen, etj. Pllombat përveç numrit serik, duhet të përmbajnë logon e **OSTT**-së dhe BarCode-in, në brendësin e të cilit në formë elektronike janë të fshehura shënimet e pllombës, me dëshirën e palës tjetër mund të vendoset pllomba shtesë, standardet e së cilës duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e këtij paragrafi.
- 10.2.2.5 Pllombat duhet të jenë të dallueshme nëse instalohen në pika të ndryshme të të njëjtit **grup (sistem) matës**. Mjafton që ky dallim ndërmjet pllombave të jetë vizuel, duke e ndryshuar vetëm ngjyrën e pllombave nëpër pika të ndryshme të të njëjtit **grup (sistem) matës**.

### 10.2.3 Kontrolli i pajisjeve pllombuese

- 10.2.3.1 Pajisja pllombuese duhet të sigurohet nga **Operatori i Sistemit** për secilin operator të autorizuar për të hequr dhe zëvendësuar pllombat e instaluar. Përveçse kur kryhen punë urgjente, asnjë operuesi të cilit i është siguruar një pajisje pllombuese nuk i lejohet të heqë një pllombë të instaluar.
- 10.2.3.2 Në qoftë se janë kryer punë urgjente që kanë pasur nevojë për heqjen e një pllombe, **Operatori i Sistemit** duhet të sigurojë se puna e cila është kryer inspektohet më pas

nga një operues i cili është i autorizuar të heqë dhe të vendosë pllombat e instaluara dhe që instalimi ripllombohet nga ai operues. **Operatori i Sistemit** duhet të sigurojë për operatorin i cili i ripllombon instalimet qasje në instalimet, të dhëna të punimeve të kryera dhe të atyre të cilët kanë ndërmarrë punët në mënyrë të atillë që operatori mund të sigurojë vetveten për integritetin e instalimit që është duke u ripllombuar.

- 10.2.3.3 Pllombat e shtypura nuk duhet të huazohen – këmbehen apo transferohen ndërmjet operuesve dhe asnjë nga **Operatorët e Sistemit** nuk duhet të mbajë kopje të dyfishta të pllombave. Kur operuesi mbaron punën e pllombimit të pajisjeve në emër të një **Operatori të Sistemit, Operatori i Sistemit** duhet të shkatërrojë menjëherë vulat e shtypura të lëshuara nga ai operator.
- 10.2.3.4 Pllombat e shtypura të cilat nuk kanë shenja të lexueshme nuk duhet të përdoren dhe duhet të shkatërrohen menjëherë nga **Operatori i Sistemit. Operatori i Sistemit** mund të caktoj që të prodhohen dhe t'i dorëzohen operatorit një grup zëvendësues pllombash me të njëjtin identifikim ose ndryshe t'i jepet operuesit me zgjedhjen e tij një pajisje pllombuese zëvendësuese me një identifikues të ndryshëm nga ai i mëparshmi.
- 10.2.3.5 **Operatori i Sistemit** duhet të mbaj të dhëna se kur i dorëzohet një pajisje pllombuese një operuesi ose kur dërgohet pajisja për riparim. Për pllombat në përdorim, kjo e dhënë duhet të tregojë:
- a) Shenjën identifikuese të secilit grup pllombash në përdorim,
  - b) Emri i personit të cilit iu dorëzuan pllombat ose kompanisë së cilës i janë dërguar për riparim,
  - c) Datat e lëshimit dhe kthimit
- 10.2.3.6 Të dhënat për pllombat e shkatërruara tregojnë datën dhe arsyen e shkatërrimit të tyre.
- 10.2.3.7 Për pllombat që kanë humbur ose janë vjedhur, duhet të mbahet një shënim që tregon datën dhe vendin e humbjes.
- 10.2.3.8 Të gjitha të dhënat e marra në përputhje me seksionin 10.2.3.4 duhet të mbahen për një periudhë prej 10 vjetësh nga shkatërrimi ose humbja e pllombave dhe të jenë të gatshme për **Operatorin e Tregut** ose **Zyrën e Rregullatorit për Energji** me kërkesë të tij.
- 10.2.3.9 Me një njoftim të arsyeshëm, **Operatori i Sistemit** duhet të riprodhoj pllombat e kërkuara për inspektim nga **Operatori i Tregut** ose **Zyra e Rregullatorit për Energji** me kërkesë të tij.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 35 nga 42</i>

### 10.3 Pajisjet me mikroprocesor

#### 10.3.1 Mbrojtja me pasvord

10.3.1.1 Për mbrojtjen e të dhënave të matura nga hyrjet e paautorizuara dhe për të siguruar që modifikimet në opsionet e matjes mund të ndërmerren vetëm nga personat e përshtatshëm dhe të autorizuar, qasja lokale dhe prej distance që nuk kërkon heqjen e kapakut të pllombuar në përputhje me kërkesat e seksionit 10.2 mund të jetë e mundur vetëm me futjen e një pasvordi të saktë.

10.3.1.2 Protokollin e komunikimeve duhet të sigurojë që qasja të jetë e mundshme vetëm në ato zona të përcaktuara nga pasvordi i futur. Ku është e mundur, pasvordet e nivelit 1 dhe 2 duhet të ruhen në sistemet e përdorura për rigjenerimin e të dhënave në mënyrë të tillë që të mos jenë të lexueshme nga operatorët e rigjenerimit të të dhënave.

10.3.1.3 Numri i rasteve gjatë secilës orë të përpjekjeve për të pasur qasje në të dhënat e matjeve nëpërmjet porteve lokale dhe në distancë, dhe që pasvordi futet gabim do të numërohet nga pajisja., nëse numri i përpjekjeve të pasuksesshme për të futur pasvordin e duhur arrin në 5 procesi i logimit do të pamundësohet deri në fund të asaj ore.

10.3.1.4 Ofrimi i një minimum prej 4 nivelesh sigurie.

#### 10.3.2 Niveli 1

10.3.2.1 Pasvordi i nivelit 1 do të ofrojë qasje pa mundësi ndryshimi në:

- a) Grumbulluesin e të dhënave ose identifikuesin e **matësit**
- b) Vlerat e fuqisë për secilën periudhë të barazimit përfundimtar si janë specifikuar në seksionin 8.2,
- c) Vlerat e grumbulluara të transferimit të energjisë si janë specifikuar në seksionin 8.2
- d) Vlera maksimale e fuqisë (KW dhe/ose kVArh) për secilin ngarkim të programueshëm ose periudhë rishikimi statistikash nëse është e mundshme dhe/ose e kërkuar për arsye ngarkimi të qasjes në rrjet,
- e) Energjia e mbledhur aktive siç kërkohet për arsye tarifash ndërmjet **përdoruesit të sistemit** dhe furnizuesit
- f) Aty ku është e përshtatshme, herësin e transformimit të transformatorëve matës,
- g) Shenjat e alarmit
- h) Data dhe ora e **grumbulluesit të të dhënave**, dhe

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 36 nga 42</i>

- i) Ku kombinohen **grumbulluesi i të dhënave** dhe **njehsori(matësi)**, faktorët e korrektimit që janë aplikuar.

### 10.3.3 Niveli 2

10.3.3.1 Përveç nivelit të mëparshëm të qasjes, pasvordi i nivelit 2 do të ofrojë qasje në:

- a) Leximin dhe korrektimin e datës dhe orës së **grumbulluesit të të dhënave**
- b) Leximin dhe rivendosjen e vlerës së fuqisë maksimale (KW dhe/ose kVARh)

### 10.3.4 Niveli 3

10.3.4.1 Përveç nivelit të mëparshëm të qasjes, pasvordi i nivelit 3 do të ofrojë qasje në:

- a) Të dhënat e programit dhe rregullimet tarifore siç janë përcaktuar në 10.3.2.1
- b) Pasvordet e nivelit 1, 2 dhe 3.

### 10.3.5 Niveli 4

10.3.5.1 Përveç nivelit të mëparshëm të qasjes, pasvordi i nivelit 4 do të ofrojë qasje në:

- a) Kalibrimin e **pajisjeve të matjes** ku kjo gjë mund të kryhet pa thyerjen e vulës,
- b) Vendosjen e herësit të transformimit të TM, ku është e përshtatshme
- c) Vendosjen e faktorëve korrektues nëse ka të tillë,
- d) Pasvordet për nivelet 1, 2, 3 dhe 4.

## 10.4 Siguria e bazës së të dhënave të matjes

10.4.1.1 **Operatori i Sistemit** duhet të zbatojë kontrolle për të siguruar se të gjitha të dhënat e mbajtura në bazën e të dhënave mbeten konfidenciale dhe duhet të kufizoj qasjen për ata punonjës përgjegjës të të cilëve përfshijnë operimin dhe kontrollimin e bazës së të dhënave. Vetëm në rastet kur është e domosdoshme ndihma nga TI, do të lejohet përfshirja e stafit mbështetës të TI në operimin e bazës së të dhënave.

10.4.1.2 Për të minimizuar rrezikun e gabimeve apo të mashtrimeve, **Operatori i Sistemit** do ta kufizojë qasjen në:

- a) Programe dhe të dhëna, përfshirë nivelet e sistemit dhe aplikimit,
- b) Pjesët mekanike të kompjuterëve që përdoren për operimin në **bazën e të dhënave**, përfshirë терминалет, kabllot, lexuesit e disqeve dhe shiritat ku janë deponuar të dhënat, dhe
- c) Do të zbatoj procedura efektive të monitorimit dhe rishikimit për të siguruar që qasjet e paautorizuara nuk mund të ndodhin.

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 37 nga 42</i>

10.4.1.3 Për të minimizuar rrezikun e ndërprerjes së operimit të bazës së të dhënave, **Operatori i Sistemit** do të vendosë:

- a) trajnim të përshtatshëm për të gjithë stafin,
- b) aranzhime të përshtatshme mirëmbajtjeje për pjesët mekanike të kompjuterit, programet dhe të gjitha dokumentacionet relevante,
- c) aranzhime dhe lehtësira të përshtatshme të mbështetjes të TI
- d) masa të zbulimit dhe parandalimit të viruseve,
- e) monitorim të performancës së sistemit,
- f) procedurat formale të kontrollit të ndryshimeve,
- g) procedurat e dokumentuara të sigurisë që janë objekt i rishikimeve të rregullta.

## 10.5 Kërkesat për restaurimin e prishjeve

10.5.1.1 Për të siguruar një restaurim të shpejtë të shërbimeve, **Operatori i Sistemit** duhet të disponoj me sistemet e tij të kompjuterëve për të siguruar që të dhënat mund të rigjenden në mënyrë të saktë dhe që përpunimi i të dhënave rifillohet në mënyrë të saktë sa më shpejtë që mundet. Në veçanti, **Operatori i Sistemit** duhet të:

- a) Arkivoj dhe rezervoj të dhënat në një mënyrë të tillë që lejon restaurimin me minimumin e përpunimit retrospektiv.
- b) Ruaj të gjitha të dhënat e përpunuara në mënyrë të atillë që mund të ripërpunohen me minimumin e vonesës,
- c) Vendos dhe testoj në mënyrë periodike procedurat e restaurimit nga prishjet,
- d) Siguroj që sistemet e tij të operimit mbrojnë integritetin e të dhënave në rast të një prishjeje në sistem, përfshirë dispozitat e transaksioneve të qasjes.

## 11 Testimi i grupeve (sistemeve) matëse

### 11.1 E përgjithshme

11.1.1.1 Testimi i **grupeve (sistemeve) matëse** në tërësi dhe të komponentëve individuale të **grupeve (sistemeve) matëse** ndërmerret në disa faza:

- a) Para dhënies së miratimit të tipit,
- b) Gjatë kalibrimit dhe verifikimit të komponentëve individual menjëherë para ose në mes të instalimit,

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 38 nga 42</i>

- c) Ri-verifikimi në disa faza gjatë jetës së pajisjeve përcaktuar nga tipi gjenerik i komponentit ose tipi specifik i komponentit, cilido është më i shkurtër.
- d) Në rastet e **grupeve (sistemeve) matëse** në **pikat e kyçjes** ku transferimi i energjisë është i madh, do të ndërmerret një verifikim kalibrimi në intervale të rregullta.

## 11.2 Aprovimi i tipeve

- 11.2.1.1 Do të jetë përgjegjësia e Ministrisë të aprovojë përdorimin e tipeve të caktuara të pajisjeve matëse si komponent të grupeve (sistemeve) matëse komerciale në Kosovë. Përpara se të lëshohet një çertifikatë miratimi, Ministria do të ndërmarrë teste të atilla miratimi të tipit siç kërkohet nga ligji ose që Ministria mendon se janë të përshtatshëm në rrethanat e caktuara.
- 11.2.1.2 Ministrisë do t'i jepet e drejta të udhëzojë një laborator të përshtatshëm të akredituar për të ndërmarrë testet e aprovimit të tipit në emër të saj.
- 11.2.1.3 Aty ku pajisjet matëse janë pajisje të një modeli për të cilin është dhënë miratim nga Bashkimi Evropian dhe nuk është revokuar nga ndonjëri nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian ose ndonjë shtet tjetër në Zonën Ekonomike Evropiane, atëherë Ministrisë do t'i jepet e drejta të lëshojë një çertifikatë miratimi pa ndërmarrë ndonjë testim të mëtejshëm.
- 11.2.1.4 Në rast se hiqet miratimi i tipit të ndonjë matësi nga Ministria atëherë **Operatori i Sistemit** do të zëvendësojë matësit, brenda 6 muajsh nga marrja e vendimit për revokim.

## 11.3 Kalibrimi dhe verifikimi

- 11.3.1.1 Të gjithë matësit, **TMT** dhe **TMRR** do të kalibrohen dhe verifikohen në përputhje me Ligjet e Kosovës përpara fillimit të operimit komercial.
- 11.3.1.2 Aty ku pajisjet matëse mbajnë shenjën verifikuese fillestare të Bashkimit Evropian dhe/ose janë të pllombuara nga pllombat e kalibrimit të një laborator testimi të autorizuar për kalibrim dhe verifikim të pajisjeve matëse në ndonjë nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian ose ndonjë shtet tjetër në Zonën Ekonomike Evropiane, atëherë pajisjet do të pranohen si të kalibruara dhe të verifikuara në Kosovë.

#### 11.4 Kalibrimi periodik dhe ripërtëritja

11.4.1.1 Matësit elektronik statik do të testohen dhe ri-çertifikohen periodikisht dhe do të përdoren sipas nevojave në intervale siç është vendosur në çertifikatën fillestare verifikuese ose siç është përcaktuar nga Ministria.

11.4.1.2 Data dhe rezultatet e të gjitha testeve duhet të futen në regjistrin e matësve. Kohë pas kohe, mund të kërkohen testime speciale jashtë testimeve të përcaktuara.

#### 11.5 Testimet rutinore në kyçjet me kapacitet të madh të Transferimit

11.5.1.1 Përveç kërkesave për ndonjë riverifikim në secilën periudhë 10 vjeçare, **Operatori i Sistemit** duhet të ndërmarrë një kontroll saktësie mbi 20% të secilit tip të matësit të instaluar në **pikat e kyçjes** në rrjetin e tij ku fuqia transferuese tejkalon 500 KW. Këto teste do të planifikohen në mënyrë të tillë që të ketë një shpërndarje testimesh të njëtrajtshme për çdo tip matësi gjatë periudhës 10 vjeçare siç praktikohet.

11.5.1.2 Testi i ndërmarrë do të tregoj nëse saktësia e përgjithshme është brenda kufirit të përqindjes së gabimit treguar më poshtë:

Standardet e saktësisë për testimet në vend		Kufijtë e përqindjes së gabimit të njehsorit		
Klasa e njehsorit nën testim	Përqindja maksimale e pasaktësisë së pajisjeve testuese %	Njehsori aktiv i pakompensuar	Njehsori aktiv i kompensuar	Njehsori reaktiv
0.2	±0.2	±0.4	±0.5	
0.5	±0.2	±0.7	±0.7	
1.0	±0.6	±1.6	±1.6	
2.0	±0.6	±2.0	±2.0	
≥2.0	±1.0			±2.5
3.0	±1.5			±3.5

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 40 nga 42</i>

- 11.5.1.3 Në rastin e matësve të energjisë aktive, testimi mund të ndërmerret me anë të një testimi me injektim ose me ngarkesë, duke marrë parasysh që ngarkesa e rrymës të jetë ndërmjet 10% dhe 120% për rastet e matësve që punojnë me **TMRR** dhe ndërmjet 10% dhe 100% për rastet e matësve pa **TMRR** dhe faktori i fuqisë të jetë ndërmjet 0.5 dhënje dhe 0.8 marrje. Testimet me injektim do të ndërmerren me një faktor fuqie prej 1.0 dhe duke përdorur rrymë të injektuar ndërmjet 5% dhe 120% në rastet e matësve nëpërmjet të **TMRR** dhe ndërmjet 5% dhe 100% në rastet e matësve pa ndërmjetsim të **TMRR**.
- 11.5.1.4 Matësit reaktiv do të testohen vetëm me një test injektimi që do të ndërmerret duke përdorur një rrymë të injektuar ndërmjet 20% dhe 120% në rastet e matësve që punojnë me anë të **TMRR** dhe ndërmjet 20% dhe 100% në rastet e matësve pa **TMRR** në faktor fuqie zero.
- 11.5.1.5 Nëse një test saktësie në vend tregon se matësi nuk përmbush kufijtë e kërkuar të gabimit atëherë, matësi do të zëvendësohet dhe rikalibrohet në një laborator të autorizuar, përveç se në rastet që mund të tregohet se teprica në gabim është një gabim në testim për shkak të luhatjeve në ngarkesën e rrymës.
- 11.5.1.6 Çdo vit **Operatori i Tregut** duhet të krahasoj rezultatet e testeve për të gjithë matësit e të gjitha tipeve të testuara gjatë dy viteve paraprake. Aty ku tregohet se gabimet e matësve për një tip të veçantë matësi, nuk përshtaten me një lakore normale shpërndarjeje të paanshme, në rrethanat e tilla do t'i tërhiqet vërejtja e Ministrisë dhe do të kërkohet largimi i tyre nga përdorimi.

## **11.6 Transformatorët matës**

### **11.6.1 Të përgjithshme**

11.6.2 Të gjithë transformatorët matës do të jenë objekt i kalibrimeve dhe testimeve të mëposhtme.

### **11.6.3 Kalibrimi fillestar**

11.6.3.1 Transformatorët matës të rinj do të kalibrohen para futjes në operim komercial në çfarëdo vendi, në përputhje me rregullat e përshtatshme dhe këtë **Kod të Matjes**. Evidencat do të jenë të gatshme për inspektim në formën e çertifikatave testuese, për të treguar se transformatorët matës janë në përputhje me klasën e saktësisë dhe kufijtë e gabimit. Ky informacion do të ofrohet për përfshirje në regjistrin e matjes.



	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 41 nga 42</i>

#### 11.6.4 Testimi periodik

11.6.4.1 Testimi periodik i transformatorëve matës, nuk kërkohet normalisht përveçse në rastet kur haset një shkallë e lartë dështimi me një tip të caktuar. Në atë rast, Ministria do të vendos një rutinë testesh dhe një periudhë maksimale ndërmjet testimeve. Për të minimizuar efektin e ndërprerjeve në sistemin kryesor, pritet që të gjitha testet rutinë do të caktohen në mënyrë të atillë që të përkojnë me mirëmbajtjen e rregullt të pjesëve kryesore të impiantit elektrik. Teste të tjera kërkohen vetëm kur një defekt evident ka ndodhur ose ka arsye të mendohet se ka ndodhur një defekt.

#### 11.7 Grumbulluesit e të dhënave

##### 11.7.1 Të përgjithshme

11.7.1.1 Të gjithë **grumbulluesit e të dhënave** do të jenë objekt i kërkesave të mëposhtme për testime.

##### 11.7.2 Kalibrimi fillestar

11.7.2.1 Grumbulluesit e rinj të të dhënave do të testohen para se të vendosen në funksionim komercial në çfarëdo vendi, në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e funksionimit teknik të **RDC** dhe të këtij **Kodi të Matjes**. Evidenca që testet janë kryer do të jetë e gatshme për inspektim nga **Operatori i Tregut**. Ky informacion do të përfshihet në regjistrin matës.

##### 11.7.3 Testimi periodik

11.7.3.1 Testimi periodik nuk kërkohet për **grumbulluesit e të dhënave**, testet kërkohen vetëm kur një defekt evident ka ndodhur ose ka arsye të mendohet se ka ndodhur një prishje.

### 12 Pagesa për grupet (sistemet) matëse

12.1.1.1 Të gjitha kostot në lidhje me instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e të dhënave matëse (përfshirë ndonjë kosto të infrastrukturës së komunikimit) do të mbulohen ashtu siq parashifet me **Metodologjinë e Taksave të Kycjes në rrjetin e transmisionit të Kosovës**.

12.1.1.2 Në përputhje me kushtet e përcaktuara në **Ligjin për Energjinë Elektrike**, aty ku është përshtatshme **Rregulli për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji**, kërkesat e një **përdoruesi të sistemit** për ndryshim në pajisjet matëse më shpesh se njëherë në një periudhë prej dymbëdhjetë muajsh, **Operatorit të Sistemit** do t'i jepet e drejta të pres derisa pajisjet matëse të instaluar pas kërkesës së hershme të kenë qenë në përdorim për një periudhë minimumi dymbëdhjetë muajsh para se ai

	<b>KODI I MATJES</b>	<b>PO-KO-006</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 42 nga 42</i>

ta ndërroj atë me pajisje matëse që i plotësojnë kërkesat e **përdoruesit të sistemit**, përveçse në rastet kur **përdoruesi i sistemit** bie dakord të paguaj shpenzimet (kostot) që shoqërojnë ndryshimin e pajisjeve. Aty ku një **përdorues i sistemit** zgjedh të paguaj për një ndryshim në pajisjet matëse që kryhen në më pak se dymbëdhjetë muaj pas ndryshimit të mëparshëm, pajisjet do të mbeten pronë e **Operatorit të Sistemit** në përputhje me **Ligjin për Energjinë Elektrike**.

(Fundi i dokumentit)